



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 27

Prishtinë, më 07. 09. 2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Enis Kervan, Ramë Buja, Ramadan Avdiu, Eqrem Kryeziu, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi, Ardian Gjini, Nexhat Daci dhe Dragisa Miric.

Në mbledhje, i ftuar, ishte i pranishëm zëvendëskryeministri - Hajredin Kuçi.

Të pranishëm nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit ishin: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Ilaz Rudaku.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara,**
 - 2. Paraqitja e zëvendëskryeministrit, Hajredin Kuçi për raportet e Qeverisë me EULEX-in,**
 - 3. Të ndryshme.**
- 1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara**

Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të 05. 06. 2009 dhe 29. 07. 2009 dhe u njoftua për Raportin e vizitës zyrtare të delegacionit në Republikën e Turqisë.

- 2. Paraqitja e zëvendëskryeministrit, Hajredin Kuçi për raportet të Qeverisë me EULEX-in**

Sabri Hamiti - I njoftoi anëtarët e Komisionit se, me ftesë të Komisionit, në mbledhje ishte i pranishëm zëvendëskryeministri, Hajredin Kuçi, që t'i paraqiste raportet e Qeverisë me EULEX-in, në fokus të proceseve aktuale.

Hajredin Kuçi – Për zhvillimet e fundit rreth Protokollit ndërmjet EULEX-it dhe Serbisë, anëtarëve të Komisionit ua shpërndau kopjen e projektit të Protokollit.

Projektin e Protokollit policor, sapo e morëm e diskutuam në Qeveri dhe me presidentin. Dolëm me konstatime që ishin të publikuara në opinionin publik. Protokollin është negociuar me Beogradin dhe për asgjë nuk është pyetur ndokush nga Prishtina.

Çështje diskutabile ishte duhej a nuk duhej ta nënshkruante EULEX-i një Protokoll të tillë, meqenëse vendin jashtë e përfaqësojnë vetëm institucionet e Kosovës, apo institucionet me autorizim të institucioneve të Republikës së Kosovës. Kemi menduar se EULEX-i nuk ka pasur autorizim për një gjë të tillë, sepse ka rol mbikëqyrës dhe këshillëdhënës. Po ashtu për përmbajtjen e Protokollit kemi pasur reagime, sepse mund të ketë ndikim në lëndimin e sovranitetit të vendit tonë, ose mund të ketë ndikim në perceptimin se dikush po e kontrollon ose mund të ketë ndikim në kontrollimin e një pjese të territorit të Republikës sonë.

Në bisedë me përfaqësuesit e BE-së është cekur se Protokollin i nevojitet Serbisë për liberalizimin e vizave, që gjerë më 25 shtator duhet ta dorëzojë në Bruksel çështjen e rregullimit të kufijve me fqinjët në aspektin e kontrollit kufitar, në këtë rast edhe me Kosovën. Në Projektprotokoll është përdorur termi border/boundary, që në perceptimet tona është kufi shtetëror, ndërsa në perceptimet e Serbisë është kufi administrativ.

Duhet ta pranojmë se kemi një trysni nga bashkësia ndërkombëtare që ta pranojmë Protokollin në kuptim të agjendës për integritet evropian, mirëpo qëndrimi i institucioneve të Kosovës lidhur me Protokollin mendoj se nuk do të ndryshojë pa u ndryshuar përmbajtja e Projektprotokollit.

Sa u përket raporteve ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe EULEX-it, ato janë korrekte dhe legale. Reagimi ynë nuk ka qenë reagim ndaj EULEX-it dhe pranisë së tij, por reagim i EULEX-it në raport me Serbinë. Vazhdimisht kemi pasur respekt për praninë e EULEX-it dhe nevojë për praninë e tij, si dhe jemi përpjekur të tregojmë se EULEX-i nuk ka mandat qeverisës, por mandat këshillëdhënës dhe mbikëqyrës. Kemi themeluar një bord të përbashkët për sundimin e ligjit. Ai mban takime të rregullta, nuk ka fuqi vendimmarrëse, por vetëm fuqi këshillëdhënëse.

Ne nuk kemi raport dhe plan konkret të EULEX-it për rendin dhe ligjin në Kosovë, përkundër kërkesave tona të vazhdueshme, që nga marsi i vitit 2008. Në veçanti kemi kërkuar të dimë për Planin e veprimeve në Veri, jemi përpjekur t'i shpejtonim hapat që merreshin për vënien e kontrollit doganor në pikat 1 dhe 31 dhe nuk jemi të kënaqur me veprimet që janë bërë deri më sot. Ajo pjesë është shndërruar në një oazë të kontrabandës dhe të krimit, që fatkeqësisht më shumë ka qenë e kontrolluar nga UNMIK-u se sa kontrollohet sot. Ne do të vazhdojmë të kemi raporte korrekte me EULEX-in mbi bazën e strukturës legale që ka Kosova, por edhe raporte për efektivitetin në fushën e rendit dhe të ligjit.

Xhavit Haliti - Kërkoj të njoftoj se cilat pika të marrëveshjes së kontestimit të Qeverisë së Kosovës, çka i obligon Qeverinë e Kosovës dhe institucionet e Kosovës nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet EULEX-it dhe Serbisë dhe kur është njoftuar Qeveria e Kosovës për projektin e Protokollit.

Hajredin Kuçi - Qeveria e Kosovës, në marrëveshjen e Projektprotokollit, fillimisht konteston procedurën rreth Protokollit, përgatitja dhe negociimi i së cilës janë bërë diku tjetër. Çështje tjetër kontestuese është nënshkrimi i marrëveshjes me Serbinë pa autorizimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, që mendojmë se nuk kanë të drejtë, po ashtu kontestuese është përmbajtja e Protokollit lidhur me kufijtë, për të cilët është menduar të bëhet një kompromis, duke i quajtur kufijtë si kufij/kufij administrativë, sipas logjikës që t'i perceptojmë si kufij, kurse pala tjetër si kufij administrativë. Kjo marrëveshje do t'i obligonte institucionet e Republikës së Kosovës të zbatohet në tërë territorin e saj. Projekti i Protokollit është sjellë, pasdite, më 27 korrik. Po këtë ditë u është dhënë edhe kryeministrit, edhe presidentit.

Nexhat Daci - Mendon se gabimi është bërë në trajtimin e 6-pikëshit, që do të na përcjellë gjithmonë, sepse nuk është dashur të nxitohej për përgjigjen e Ban Ki Munit, pa konsultime të mëtejme. Gabimi i dytë mendon se është bërë në aspektin e pragmatizmit, meqë ai dokument nuk ka vdekur asnjëherë nëse e shikojmë në vazhdimësi. Vërejtja tjetër është se për çështje kaq të mëdha nuk mund të shkëputemi nga lëvizja e opozitës-pozitës. Në planet e shtetformimit dhe të demonstrimit të kapaciteteve të shtetit, nuk ka ose nuk duhet të ketë opozitë. LDD-ja gjithmonë do t'i mbështetë dokumentet e Kosovës, do t'i

respektojë Kushtetutën dhe parimet kushtetuese. Neve na mungon kapaciteti elementar i respektimit të rregullave të funksionimit të një shteti.

Ibrahim Gashi - Lidhur me projektin e Protokollit tha se ky dokument ka përmbajtje shqetësuese, në të nuk figurojnë institucionet e Kosovës, por vetëm institucioni i EULEX-it dhe Serbia. Në pjesën hyrëse pjesëmarrësit e dokumentit pajtohen se bashkëpunimin do ta thellojnë mbi bazën e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, që në një farë mënyre e atakon realitetin institucional dhe juridik që e ka Kosova pas 17 shkurtit. Nëse konsekuencat e këtij dokumenti rrjedhin nga obligimet e marra me anë të dokumenteve të caktuara, duhet të provojmë t'i relativizojmë ato konsekuenca dhe nëse kemi hapësirë për t'i kundërshtuar duhet të kundërshtohet dokumenti, me amendamentim, në mënyrë që institucionet e Kosovës të bëhen palë e marrëveshjes.

Lutfi Haziri - Mendon se çështja është problematike, meqenëse një institucion monitorues e mbikëqyrës ka vepruar pa dijen dhe pa koordinim me Qeverinë. Përmbajtja e dokumentit i përfshin tri çështje që duhet t'i kemi parasysh: Rezolutën 1244, Planin 6-pikësh të Sekretarit të Përgjithshëm dhe aksionin e përbashkët të BE-së për Deklaratën e koordinuar të Pavarësisë. EULEX-i në këtë dokument nuk e përmend atë dhe nuk nënshkruan në emër të Kosovës. Në këto veprime plotësisht mbështes angazhimin e Qeverisë dhe të presidentit për zbatimin e Kushtetutës.

Ardian Gjini - Tha se këto biseda është dashur të zhvillohen në shkurt të këtij viti, atëherë kur është thënë se po bisedohet për bashkëpunim policor. Është dashur të kërkohej se në ç'masë do të bëhej ky bashkëpunim dhe çka do të rridhte prej tij. Kjo nuk është bërë. Kontributi i vetëm që mund ta japim është justifikimi i mospunës, i neglizhencës, i moskompetencës totale të Qeverisë së Kosovës, jo vetëm në këtë rast, por në vazhdimësi. Qeveria mban 90% të fajit për dëmin e madh që i është bërë Kosovës.

Ramë Buja - Lidhur me situatën e krijuar mendon se është i domosdoshëm një takim urgjent për sqarim të detyrave që kanë EULEX-i dhe Qeveria e Kosovës. Nuk ka mundësi të respektohet një akt tjetër, mbi aktin më të lartë ligjor të shtetit tonë - Kushtetutës.

Ramadan Avdiu - Po bisedojmë për një problem që është shqetësues, si për pozitën, ashtu edhe për opozitën. Kërkoj ta dinte se pas njoftimit të Qeverisë për projektin e Protokollit dhe pas qëndrimit të institucioneve tona, a ka ndonjë shenjë të fleksibilitetit nga EULEX-i, për ndryshimin e pikave kontestuese nga Qeveria.

Hajredin Kuçi - Me reagimin tonë kemi arritur të mos nënshkruhet projekti, i cili ishte paraparë të nënshkruhej shumë më herët. Pa autorizim të institucioneve të Republikës së Kosovës nuk do të ketë pëlqim nga ne dhe nuk do të ketë zbatim në Kosovë.

Eqrem Kryeziu - Bashkëpunimi ndërkufitar dhe rajonal kundër krimit të organizuar është detyrë e vendeve ballkanike për integrim në BE. Është delikat fakti se EULEX-i e ka hartuar një projekt në emër të Kosovës. Për këtë e mbështes propozimin e z. I. Gashit që të gjendet një modalitet në këtë rast. Mbështes reagimin e institucioneve të Kosovës lidhur me projektin e Protokollit.

Hajredin Kuçi - Kemi pasur një takim me z. N. Daci, z. E. Kryeziu, z. I. Gashi për letrën e datës 12 qershor të Ban Ki Munit, jo për 6-pikëshin dhe e dimë se çfarë qëndrimi kemi mbajtur lidhur me të.

Nexhat Daci - Tha se ka kërkuar që ai takim të jetë informues dhe ta kemi edhe një takim. Në atë takim ka pasur qëndrime shumë pozitive të pjesëmarrësve dhe mendoj se devijimi është 100% prej atëherë.

Sabri Hamiti – Të mbahej një mbledhje si kjo ishte e domosdoshme për momentin politik që po kalonte Kosova, por edhe për një trajtim brendainstitucional të kësaj çështjeje, duke pasur parasysh faktin se çështjet e mëdha të ne fillojnë të diskutohen në shtyp para se të diskutohen në institucione. Qeveria e Kosovës dhe institucionet e saj, nuk kanë pse të nënshkruajnë ose të pranojnë dokumente, që konsiderohen të dëmshme për rendin dhe që shkelin dispozitat kushtetuese, sepse është detyrë e përfaqësuesve institucionalë ta mbrojnë rendin kushtetues.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E hartoi:

Njësia për Mbështetje të Komisionit

Kryetari i Komisionit
Sabri Hamiti
